

Letërnjoftimi i Komunës së

**OBILIQT**

**2014**

Maj, 2015






## Fakte

- Buxheti i Komunës së Obiliqit ka pasur trend pozitiv të rritjes në katër vitet e fundit. Nga 4.3 milionë euro sa ka pasur në dispozicion në 2013, gjatë 2014, Komuna e Obiliqit ka pasur nën menaxhim rreth 5.2 milionë euro.
- Në vitin 2014, Obiliqi ka arritur të shndërrohet në komunë mesatare sa i takon të hyrave komunale. Obiliqi qëndron e 14 sa i takon të hyrave komunale.
- Komuna e Obiliqit gjatë një viti shpenzon mesatarisht deri në 50 mijë euro për rrymë, deri në 25 mijë euro për ujë dhe deri në 25 mijë euro për mbeturina. Këto kategori të shpenzimeve kanë shënuar rënie në vitin 2014 në krahasim me vitet paraprake.
- Edhe shpenzimet në derivate, telefoni fikse e mobile, në dreka dhe darka zyrtare, si dhe në riparime dhe udhëtime zyrtare kanë rënë gjatë 2014 në krahasim me vitet paraprake. Shpenzimet për derivate, ku përfshihen nafta për vetura zyrtare, për gjenerator si dhe për ngrohje qendrore, gjatë 2014 kanë qenë në total 47 mijë euro, apo rreth 40 mijë euro me pak se gjatë 2013.
- Komuna e Obiliqit ka gjithsejtë 625 persona të punësuar, ku përfshihen 89 në Administratë dhe të tjerët janë në sistemin shëndetësor dhe atë arsimor.
- Obiliqi ka të punësuar një shërbyes civil për 248 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 331 persona, prej tyre 249 janë mësimdhënës. Në Komunën e Obiliqit raporti nxënës/mësimdhënës është 30.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 205 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Obiliqit është 108.8. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Gjatë vitit 2014 në Komunën e Obiliqit janë regjistruar 69 biznese të reja, pjesa më e madhe e tyre i takojnë bizneseve nga fusha e tregtisë. Krahasuar me vitet paraprake vërehet trend në rënie i regjistrimit të bizneseve të reja.
- Nga 16 premtime të dhëna gjatë fushatës zgjedhore, kreu i Komunës së Obiliqit deri në maj të 2015 ka përmbushur 25% e tyre, realizimi në shkallë vendi është 24%.

## 2 Qeverisja komunale


Obiliqi deri në zgjedhjet e fundit (2013) është udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Pas këtyre zgjedhjeve fitues ka dal Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Ish kryetari i Obiliqit Mehmet Krasniqi ka humbur garën ndaj kandidatit Xhafer Gashi. Ky i fundit në raundin e parë ka marr 26% të votave kundrejt Krasniqit i cili ka siguruar 30%. Në balotazh Krasniqi ka siguruar 46% të votave, ndërsa Gashi 54%.

Grafikoni nr .1 Numri i votave në raundin e parë ndërmjet Xhafer Gashit dhe Mehmet Krasniqi



Pas zgjedhjeve, Kryetari i Komunës Xhafer Gashi ka arritur koalicion me Partinë Demokratike të Kosovës dhe me Partinë 'Lëvizja për Bashkim'.


Grafikoni nr. 2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Obiliqit sipas zgjedhjeve të 2013



### 3 Buxheti i Komunës së Obiliqit

Buxheti i Komunës së Obiliqit ka pasur trend pozitiv të rritjes në katër vitet e fundit. Nga 4.3 milionë euro sa ka pasur në dispozicion në 2013, gjatë 2014, Komuna e Obiliqit ka pasur nën menaxhim rreth 5.2 milionë euro. Kjo rritje ka ardhur nga rritja e grantit nga niveli qendror, por edhe shkalla e të hyrave komunale ka pasur trend pozitiv të rritjes.


Grafikoni nr.3 Buxheti total i Komunës së Obiliqit dhe ndarjes sipas kategorive



Instituti GAP

Komuna e Obiliqit gjatë vitit 2014 ka rritur shkallën e të hyrave vetanake në rreth 220 mijë euro në krahasim me një vit paraprak. Kjo rritje ka ardhur kryesisht regjistrimi i pronave, nga tatimi në pronë si dhe të hyrat nga administrata.


Grafikoni nr.4 Të hyrat vetaneke të Obiliqit nga vitit 2011-2014



Instituti GAP


Komuna e Obiliqit për dallim nga komunat e tjera, pjesën më të madhe të hyrave komunale gjatë vitit 2014 e ka siguruar nga regjistrimi i pronave dhe përkthimi i tyre. Tatimi në pronë është e hyra e dytë më e madhe në këtë komunë.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore në Obiliqit për vitin 2014




Në vitin 2014, Obiliqi ka arritur të shndërrohet në komunë mesatare sa i takon të hyrave komunale. Obiliqi qëndron e 14 sa i takon të hyrave komunale.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave nga vështrimi i të hyrave vetanake për vitin 2014




Komuna e Obiliqit gjatë një viti shpenzon mesatarisht deri në 50 mijë euro për rrymë, deri në 25 mijë euro për ujë dhe deri në 25 mijë euro për mbeturina.

Grafikoni nr.7 Krahasimi i mes viteve në shpenzimet e Obiliqit në kategorinë e shpenzimeve komunale



Edhe shpenzimet në derivate, telefoni fikse, në atë mobil, në dreka dhe darka zyrtare si dhe në riparime dhe udhëtime zyrtare kanë renë gjatë 2014 në krahasim me vitet paraprake. Shpenzimet për derivate, ku përfshihen nafta për vetura zyrtare, për gjenerator si dhe për ngrohje qendrore, gjatë 2014 kanë qenë në total 47 mijë euro, apo rreth 40 mijë euro me pak se gjatë 2013 kur janë shënuar 87 mijë shpenzime në derivate.


Grafikoni nr.8 Krahasimi i mes viteve në shpenzimet e Obiliqit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve



## 4 Të punësuarit në sektorin publik

Komuna e Obiliqit ka gjithsejtë 625 persona të punësuar, ku përfshihen 89 në administratë dhe të tjerët janë në sistemin shëndetësor dhe atë arsimor.

Grafikoni nr.9 Të punësuarit në sektorin publik në Komunën e Obiliqit






Obiliqi ka të punësuar një shërbyes civil për 248 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti i të punësuarve në administratë për kokë banori


### Të punësuar për kokë banori



Në sektorin e arsimit janë të punësuar 331 persona, prej tyre 249 janë mësimdhënës. Në Komunën e Obiliqit raporti nxënës/mësimdhënës është 30.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.11 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Obiliqit


### Raporti Nxënës/Mësimdhënës



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 205 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Obiliqit është 108.8. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.

Grafikoni nr.12 Të punësuarit në shëndetësi sipas numrit dhe llogaritjes për kokë banori nëpër


### Punonjës shëndetësor për kokë banori



## 5 Ekonomia lokale

Gjatë vitit 2014 në Komunën e Obiliqit janë regjistruar 69 biznese të reja, pjesa më e madhe e tyre i takojnë bizneseve nga fusha e tregtisë. Krahasuar me vitet paraprake vërehet trend në rënie i regjistrimit të bizneseve të reja.


Grafikoni nr.13 Trendi i hapjes së bizneseve në Komunën e Obiliqit 2011-2014 sipas llojit



Instituti GAP

Në të njëjtën periudhë, në Obiliq janë shuar 10 biznese, pjesa më e madhe e tyre i takojnë profilit të bizneseve tregtare. Trendi i shuarjes së bizneseve ka mbetur i njëjtë në krahasim me vitet e tjera.

Grafikoni nr.14 Shuarja e bizneseve në Obiliq në total dhe sipas llojit 2011-2014



Instituti GAP

## 6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Xhafer Gashi gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 16 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z.Gashi ka arritur të realizoj 25% të premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.15 Numri i premtimeve dhe shkalla e realizimit





**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)  
[www.komunat.institutigap.org](http://www.komunat.institutigap.org)

